

KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

RR E G U L L O R E

**Mbi organizimin, strukturën, funksionimin dhe procedura e
zgjedhjes së Këshillave të bashkësive lokale në territorin e
Komunës së Vushtrrisë**

Vushtrri, 2002



Në bazë të nenit 4 dhe 5 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, dhe nenit 24 në lidhje me nenin 22 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në seancën e vet të mbajtur më 15.03.2002 me shumicë votash nxori Vendim me të cilin e aprovoi këtë:

RR E G U L L O R E

Mbi organizmin, strukturën, funksionimin dhe procedurën e zgjedhjes së Këshillave të Bashkësive Lokale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 1.

Me këtë Rregullore rregullohet organizimi, struktura, funksionimi dhe procedura e zgjedhjeve të Këshillave të Bashkësive Lokale (vendore) në territorin e Komunës së Vushtrrisë/ në tekstin e mëtejme Këshillat vendore/.

Neni 2.

Në territorin e Komunës së Vushtrrisë funksionojnë 15 Bashkësi Lokale (vendore) prej të cilave dy janë në lagjet urbane të qytetit të Vushtrrisë, ndërsa 13 Bashkësi Lokale tjera e kanë selinë në fshatra.

Organizimi dhe struktura

Neni 3.

Për tu realizuar sa më mirë funksionet e parapa në nenin 11 të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr.2000/45, nenit 22 dhe 23 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Komuna e Vushtrrisë organizon formon 15 Bashkësi Lokale, dhe këtë: Vushtrria ndahet në dy lagje /Bashkësia Lokale vendore me seli në qytet/ dhe 13 Bashkësia vendore me seli në fshatra.

Neni 4.

Përkufizimi i lagjeve të veçanta urbane (në Bashkësi vendore) të qytetit të Vushtrrisë bëhet si vijon: “Kalaja” dhe “Dardania”.

Neni 5.

Lagja (Bashkësia Lokale) Dardania

Territori i Bashkësisë Lokale “Dardania” përfshinë pjesën e qytetit që shtrihet në mes rrugës “Dëshmorët e Kombit”, rrugës “Skenderbeu” dhe lumit “Sitnica”.

Këshilli i Bashkësisë Lokale “Dardania” përbëhet nga 15 anëtarë të cilët zgjedhën nga tubimi i qytetarëve të Bashkësisë Lokale.

Neni 6.

Lagja (Bashkësia Lokale) Kalaja

Territori i Bashkësisë Lokale “Kalaja” e përfshinë pjesën e qytetit që shtrihet në mes rrugës “Dëshmorët e Kombit” dhe fshatrave Begaj, Martiraj e Poshtme, Gojbulë etj. Këshilli i Bashkësisë Lokale “Kalaja” përbëhet nga 15 anëtar të cilët zgjedhën nga tubimi i qytetarëve të Bashkësisë Lokale.

Neni 7.

Bashkësia lokale në Pantinë

Territori i Bashkësisë lokale në Pantinë përbëhet prej fshatrave: Pantinë, Akrashticë, Ashlan, Gurbardh, Liqen, Lugmir, Balaj dhe Shtruerë. Këshilli i bashkësisë lokale përbëhet prej.

Neni 8.

Bashkësia lokale në Gjytet

Territori i kësaj Bashkësi për bëhet nga këto fshatra: Gjytet, Besnik dhe Galicë.

Neni 9.

Bashkësia Lokale në Çeltinë

Territori i Bashkësisë lokale të Çeltinës i përfshinë këto fshatra: Çeltinë, Bukosh, Kullë, Vvri, Taraxhë dhe Brusnik.

Neni 10.

Bashkësia Lokale në Druar

Territori i Bashkësisë Lokale në Druar i përfshinë këto fshatra: Druar, Shalës, Rreznik dhe Mirash

Neni 11.

Territori i Bashkësisë lokale në Prelluzhë i përfshin këto fshatra: Prelluzhë, Burim, Strofc, Beqk, Gurakuq dhe Trimor.

Neni 12.

Bashkësia lokale në Prelluzhë

Territori i Bashkësisë lokale Gjytezë përfshinë këto fshatra: Gjytezë, Sumë, Rrafshmirë, Buqaj dhe Bajë.

Neni 13.

Bashkësia lokale në Maxhunaj

Territori i Bashkësisë lokale në Maxhunaj përfshinë këto fshatra: Maxhunaj, Mollas dhe Vilas.

Neni 14.

Bashkësia lokale në Gojbulë

Territori i Bashkësisë lokale në Gojbulë përfshin këto fshatra: Gojbulë, Karaçë, Miraçë, Martiraj e Poshtme, Begaj, Glebishtë dhe Lajthishtë.

Neni 15.

Bashkësia lokale në Skromë

Territori i Bashkësisë lokale në Skromë përfshinë këto fshatra: Skromë, Maletaj, Boshlan, Kurillovë, Kodërflamur dhe Qukas.

Neni 16.

Bashkësia lokale në Lumkuq

Territori i Bashkësisë lokale në Lumkuq përfshinë këto fshatra: Lumkuq, Ceceli, Martiraj e Epërme, Kunovik dhe Grykë.

Neni 17.

Bashkësia lokale në Breglum

Territori i Bashkësisë lokale në Breglum përfshinë këto fshatra: Breglum, Mavraj, Manza e Poshtme, Manza e Epërme dhe Fushëmir.

Neni 18.

Bashkësia lokale në Krasniqaj

Territori i Bashkësisë lokale në Krasniqaj përfshinë këto fshatra: Krasniqaj e Poshtme, Krasniqaj e Mesme, Krasniqaj e Epërme dhe Zogaj.

Neni 19.

Bashkësia lokale në Bletaj

Territori i Bashkësisë lokale në Bletajë përfshinë këto fshatra: Bletajë, Buzëlum, Gracë dhe Lumadh.

Neni 20.

Fshatrat përbëhen prej dy apo më tepër lagjeve (komunitete rurale).

Fshati udhëhiqet nga Këshilli i fshatit. Këshilli i fshatit përbëhet prej 5 deri 7 anëtar. Anëtarët e Këshillit të fshatit zgjedhën drejtpërdrejt nga banorët e fshatit. Në pajtim me procedurën e cila do të përcaktohet me këtë rregullore, çdo këshill i fshatit do ta zgjedhë kryetarin e tij i cili do të njihet si kryetar i fshatit dhe zëvendësi i tij do të zgjidhet nëse ekziston nevoja.

Neni 21.

Këshilli i Bashkësive lokale në fshatra përbëhet nga delegatët e fshatrave të cilat janë anëtarë të Bashkësive lokale dhe zgjidhen nga tubimet zgjedhore të fshatrave.

Numri i delegatëve të fshatrave caktohet në bazë të numrit të familjeve në fshatra dhe këtë: Fshatrat me numër deri në 20 familje e delegojnë një delegat në Këshillin e Bashkësisë lokale, fshatrat me numër deri në 100 familje i delegojnë 2 delegat në

Këshillin e Bashkësisë lokale, gjersa fshatrat me numër mbi 100 familje i delegojnë 3 delegat në Këshillin e Bashkësisë lokale.

Neni 22.

Territori i Bashkësive lokale dhe organizimi i fshatrave është përcaktuar duke iu përmbajtur parimit kur dy apo më shumë vendbanime të cilat janë gjeografikisht të lidhura në mes veti dhe me interes të përbashkët e që sipas dispozitave normative në fuqi të cilat e rregullojnë këtë lëmi u lejohej që të formojnë bashkësi vendore.

Organet e Bashkësive lokale

Neni 23.

Lagjet (Bashkësit vendore) urbane respektivisht lokalitetet zgjedhin Këshillin e Bashkësisë ose të fshatit nëpërmes të votimit të fshehtë apo të hapur varësisht si merren vesh në tubimin e qytetarëve. Këshilli i Bashkësisë apo fshatrave nga radhët e tij e zgjedh kryetarin e e Këshillit , i cili është edhe kryetar i fshatit.

Neni 24.

Në bashkësi lokale udhëheqë Këshilli i Bashkësisë lokale i cili përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha lagjeve, fshatrave dhe vendeve urbane që janë anëtare të bashkësisë lokale dhe banorë të saj.

Këshilli Bashkësisë lokale zgjidhet në harmoni me nenin 20 të kësaj rregulloreje.

Kryetari i Bashkësisë lokale-vendore zgjidhet nga anëtarët e Këshillit të bashkësisë lokale.

Neni 25.

Këshilli i Bashkësisë lokale mund të ketë 5 deri në 15 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve caktohet me vendim të veçantë të bashkësisë lokale i cili nxirret me pjesëmarrjen e tubimeve të qytetarëve.

Këshilli zgjidhet me mandat si delegatët e KK-ës Vushtrrisë. Kryetari dhe anëtarët tjerë të këshillit aktivitetin e tyre konform me këtë rregullore e zhvillojnë në baza vullnetare pa kompensim të ardhurash personale.

Neni 26.

Këshilli, anëtarët dhe kryetari i këshillit mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit nëse nga zgjedhësit e tyre konstatohet se kanë lëshime në punët e tyre.

Neni 27.

Në bazë të nevojave dhe kërkesës së qytetarëve të Bashkësisë lokale ose të ndonjë lokaliteti, apo me iniciativën e këshillit të bashkësisë lokale, mund të përcaktohet grumbullimi i vetë kontributit të qytetarëve konform me dispozitat e Statutit të komunës së Vushtrrisë.

Neni 28.

Kompetencat dhe përgjegjësit e këshillit janë:

1. Nxjerr Rregulloren e punës,
2. Nxjerr vendimin e organizimit të lagjeve urbane ose lokaliteteve fshatare (me specifikat organizative),
3. Organizon përcjellje dhe planifikon zhvillimet e lokaliteteve në bashkëpunim me Kuvendin Komunal, me komitetet e tij dhe drejtoritë komunale,
4. Emëron komisionet përkatëse për ti realizuar objektivat e lagjeve urbane-lokaliteteve dhe fshatrave,
5. Harton planet dhe programet zhvillimore të lokaliteteve në të gjitha sferat, planifikon mjetet dhe shpërndarjen e tyre sipas destinimit dhe vendimeve përkatëse të miratuara në këshill ose me deklaram me referendum të lokalitetit përkatës,
6. Ndërmerr iniciativat përkatëse për destinimin dhe rolin e objekteve në pronësi shtetërore dhe pasurive tjera të palujtëshme shtetërore në lokalitetet përkatëse.
7. Siguron të dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës përcjell gjendjen ekonomike të tyre dhe jep rekomandime e propozime në lidhje me këto.
8. Nga radhët e këshillit caktohet personi i cili do të ngarkohet me dokumentet përcjellëse të gjendjes financiare të lokalitetit dhe këtë sipas kategorive të cilat caktohen me vendim të veçantë të këshillit të lagjes përkatësisht të lokalitetit.
9. Përveç kompetencave të numëruara në këtë nen këshilli i lagjes-lokalitetit nxjerr vendim, rekomandime, urdhëresa, udhëzime dhe akte tjera që kanë të bëjnë me lokalitetet përkatëse.

Neni 29.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme të KK-ës Vushtrri, koordinon punët me lagjet urbane, lokalitetet dhe fshatrat e Komunës së Vushtrrisë, përmes kryetarëve të këshillave të lagjeve, në bashkëpunim me Kuvendin, komitetet dhe drejtoritë e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, varësisht nga specifikat që do të trajtohen.

Neni 30.

Për të gjitha punët e parapara në nenet e mëparshme të kësaj rregullore këshilli i lagjes (urbane) apo lokalitetit përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi në rast keq përdorimi eventual.

Përgjegjësia është individuale por mund të jetë edhe kolektive para qytetarëve dhe organeve përkatëse.

Neni 31.

Me vendim të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë e me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa me kërkesën e lagjes urbane respektivisht lokalitetit përkatës

fshatar, disa punë që janë në përgjegjësinë e komunës mund të barten dhe të ushtrohen në fshatra, lagje dhe vendbanime urbane.

Neni 32.

Me vendim të veçantë dhe rekomandime të Komitetit për Politikë dhe Financa në bashkësitë lokale për kryerjen e punëve mund të inkuadrojnë ndonjë punëtor dhe këtë sipas nevojës dhe në kushte të caktuara sipas Ligjit dhe akteve normative të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Dispozitat përfundimtare

Neni 33.

Në rast kundërshtimi të ndonjë dispozite të kësaj Rregullore dhe akteve të nxjerra nga organet e lagjeve urbane, fshatrave (bashkësive lokale), me dispozitat e Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr.2000/45 dhe Statutit të Komunës së Vushtrrisë do të aplikohen dispozitat e rregullores së cekur dhe Statutit të Komunës.

Neni 34.

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale me këtë Rregullore mund të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së Rregullores.

Neni 35.

Për zbatimin e kësaj Rregullore kujdesen këshillat e Bashkësive lokale dhe organet e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 36.

Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit.

Kryetari i Kuvendi
Muharrem Shabani